



Nr.protokollit 325/2023

MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT (IAAP dhe Institucionit)

Kjo marrëveshje është arritur në mes të Institucionit të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional – IAAP “Tafil Kasumaj” e përfaqësuar nga **z. Lan Stojkaj** nga komuna e Deçanit dhe Universitetit “Haxhi Zeka” e përfaqësuar nga **z. Armand Krasniqi**.

Neni 1. Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që përmes bashkëpunimit me ndërmarrjen nga sektori publik dhe privat të krijojë mundësi për nxënësit/kandidatët e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP), t’i aplikojnë njohuritë e tyre teorike në një ambient pune dhe njëkohësisht të përfitojnë ndërmarrjet nga sektorët përkatës duke iu ofruar mundësinë e përgatitjes, testimit dhe rekrutimit të punëtorëve potencial me kosto të arsyeshme.

Neni 2. Përgjegjësitë e IAAP-së

Për tu arritur ky qëllim IAAP-ja merr përgjegjësinë që të planifikojë, zhvillojë, organizojë dhe monitorojë procesin e të Mësuarit në Vendin e Punës (MVP). IAAP-ja pajtohet që do të:

1. Caktojë personin përgjegjës për MVP që do të jetë pikë kontakti në mes të IAAP-së dhe ndërmarrjes.
2. Hulumtojë tregun e punës dhe kontaktojë ndërmarrjet në profilet përkatëse të IAAP-së.
3. Përcaktojë kriteret për përzgjedhjen e nxënësëve/kandidatëve për MVP, në bashkëpunim me ndërmarrjen.
4. Informojë nxënësit dhe prindërit për mundësitë e realizimit të MVP-së në ndërmarrje.

5. Përzgjedhë dhe referon për intervistë nxënësit/kandidatët që plotësojnë kërkesat e ndërmarrjes, në mënyrë ashtu që përzgjedhja përfundimtare të bëhet nga ndërmarrja.
6. Përgatitë dhe orienton nxënësit/kandidatët e përzgjedhur për MVP për:
 - 6.1. Etikën dhe shkathhtësitë e buta në vendin e punës;
 - 6.2. Obligimet e tyre që të mbajnë të gjitha të dhënat nga ndërmarrja në besim (konfidenciale) gjatë dhe pas MVP-së.
7. Caktojë orarin varësisht nga specifikat e sektorit dhe profilit përkatës dhe në përputhje me kërkesat e ndërmarrjes.
8. Bëjë sigurimin ndaj aksidentit në bashkëpunim me DKA-në, për nxënësit (jo për të rritur) gjatë realizimit të MVP-së.
9. Mbajë kontakt të vazhdueshëm dhe bashkëpunojë me instruktorin/personin përgjegjës të ndërmarrjes përmes MPP/ instruktorit të profilit përkatës.
10. Monitorojë nxënësit/kandidatët dhe procesin e MVP-së përmes formave të ndryshme të monitorimit dhe përmes vizitave në ndërmarrje së paku një herë në dy javë. Monitorimi do të kryhet nga MPP/instruktori në IAAP.

Neni 3. Përgjegjësitë e Ndërmarrjes

Ndërmarrja pajtohet që do të bashkëpunojë në realizimin e MVP-së ashtu që të kontribuojë në aftësimin e fuqisë së re punëtore. Kësisoj ndërmarrja pajtohet se do të:

1. Ofrojë mundësi për MVP dhe njoftojë IAAP-në për numrin e nxënësve/kandidatëve që mund të pranojë gjatë një viti shkollor në profilin përkatës.
2. Informojë nxënësit/kandidatët për rregullat e brendshme të ndërmarrjes dhe siguron kushtet për sigurinë dhe shëndetin gjatë zbatimit të MVP-së, bazuar në legjislacionin në fuqi.
3. Ofrojë burimet e nevojshme për MVP si p.sh.materiale dhe bazën teknike, burimet financiare (sipas mundësive), njerëzore dhe burime të tjera.
4. Bashkëpunojë me personin përgjegjës të IAAP-së për MVP për të përcaktuar kriteret për përzgjedhjen e nxënësve/kandidatëve.
5. Caktojë një instruktor (person përgjegjës) për zbatimin e MVP-së për jo më tepër se **pesë** nxënës/kandidatë, ndërsa për profilet me rrezikshmëri të lartë, jo më tepër se **tre** nxënës/kandidatë.

6. Instruktori (personi përgjegjës) në ndërmarrje mban kontakt të vazhdueshëm me MPP/ instruktoren në IAAP. Gjithashtu instruktori/personi përgjegjës në ndërmarrje do të:

- 6.1. merr pjesë në hartimin e planit të MVP-së bazuar në kurrikulën e kualifikimit përkatës në bashkëpunim me mësimdhënësin e praktikës profesionale/ instruktoren e shkollës;
- 6.2. interviston dhe zgjedhë nxënësit/kandidatët për të kryer MVP-së;
- 6.3. dërgon listën e nxënësve/kandidatëve të përzgjedhur, tre muaj para fillimit të vitit shkollor.
- 6.4. verifikon dëshminë se nxënësi/kandidati ka të mbuluar sigurimin ndaj aksidentit;
- 6.5. njofton secilin nxënës/kandidat me rregullat e brendshme të ndërmarrjes për ofrimin e MVP-së dhe i udhëzon për masat e sigurisë dhe shëndetit në punë, në përputhje me rregulloret në fuqi.
- 6.6. organizon hapësirën e punës për secilin nxënës/kandidat duke siguruar dokumentacionin e duhur teknik dhe teknologjik, mjetet, pajisjet dhe materialet për zbatimin e sigurt të MVP-së;
- 6.7. demonstroi elemente të veçanta nga procesi i punës dhe cakton detyrat praktike në përputhje me planin e MVP-së.
- 6.8. mbanë evidencën e vijueshmërisë së nxënësve;
- 6.9. kontrollon zbatimin e detyrave të caktuara, ofron udhëzime praktike gjatë procesit të punës dhe vlerëson cilësinë e të zbatuarit.
- 6.10. verifikon dhe miraton të dhënat e regjistruara nga nxënësi/kandidati në ditarin e punës si dhe e udhëzon nxënësin/kandidatin për mirëmbajtje të portfolios.
- 6.11. vlerëson nxënësin/kandidatin në përputhshmëri me kriteret vlerësuese të planit të MVP-së.

7. Caktojë orarin e nxënësve të përzgjedhur për MVP në profilet përkatëse, sipas mundësive të ndërmarrjes.

8. Gjejë modalitete për ofrimin e kompenzimit të nxënësve/kandidatëve gjatë MVP-së. Çështja e kompenzimit do të rregullohet me kontratën për MVP-së.

11. Ofrojë një letër referencë për nxënësin/kandidatin që ka kryer me sukses MVP-në.

Neni 4. Kohëzgjatja dhe përfundimi i marrëveshjes

1. Kohëzgjatja e marrëveshjes është me afat të pacaktuar.
2. Në rast të mosrespektimit të obligimeve që dalin nga marrëveshja e MVP-së, IAAP apo ndërmarrja ka të drejtë për ndërprerje të marrëveshjes.
3. Secila palë ka të drejtën të ndërprejë këtë marrëveshje me një njoftim paraprak me shkrim, prej tridhjetë (30) ditë kalendarike.
4. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të MVP-së, palët do të përpiqen t'i zgjidhin miqësisht deri në kryerjen e kësaj marrëveshjeje.
5. Kjo marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe në dy (2) origjinale, një për IAAP-në dhe një për ndërmarrjen.
6. Kjo marrëveshje hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga të dy palët.

Rektori i Universitetit "Haxhi Zeka"

Emri dhe Mbiemri, Nënshkrimi



Drejtori i IAAP-së "Tafil Kasumaj"

Emri dhe Mbiemri, Nënshkrimi